



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 483, prot.

Gramsh, më 08/02/2021

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
NË SHËRBIMIN CIVIL  
KATEGORIA E ULËT DREJTUESE  
(PËRGJEGJËS SEKTORI)**

**Lloji i diplomës:** *“SHKENCAT EKONOMIKE*

**Niveli minimal i diplomës:** *“MASTER SHKENCOR DHE/OSE DIPLOMË E INTEGRUAR E  
NIVELIT TË DYTË”*

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu V “lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë” neni 26 dhe Kreu IV “pranimi në shërbimin civil” neni 22; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” (ndryshuar me VKM nr.748, datë 19.12.2018) Kreu II; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.351, datë 11.05.2016 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura (ndryshuar VKM nr.305, datë 05.04.2017); Vendmit nr.20, datë 25.02.2020 “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në Shërbimin Civil, për vitin 2020” të Këshillit Bashkiak Gramsh; Urdhërit nr.9, datë 20.01.2021 “Për shpallje vendesh të lira pune në administratën e Bashkisë Gramsh” të Kryetarit të Bashkisë, Njësia e Burimeve Njerëzore, shpall procedurat e lëvizjes paralele në shërbimin civil, në kategorinë e ulët drejtuese për grupin e pozicioneve:

- Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar, Drejtoria e të ardhurave, zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, kategoria III-a, klasa III-a/1;

*Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për kategorinë ekzekutive.*

**PËR PROCEDURËN E LËVIZJE PARALELE**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**LËVIZJE PARALELE:**

**18.02.2021**

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
4. Dëshminë e statusit të nëpunësit civil;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 18.02.2021***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **22/02/2021**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit bashkiagramsh.gov.al , **listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele** dhe kërkesat e posaçme, si dhe **datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet-intervista.**

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Kandidatët të cilët rezultojnë të pakualifikuar

Lista e fituesve me mbi 70(shtatëdhjetë) pikë do të shpallet në datën 15.03.2021

Njoftimi do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Afati për ankim është 3(tre) ditë duke filluar nga data 05.03.2020.

Njësia përgjegjëse, në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues ose me më pak fitues se planifikimi, rihap procedurën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil, brenda 5(pesë) ditëve kalendarike nga përfundimi i shqyrtimit të akimeve.

P/Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Joana Zani



KRYETARI

Klodian TACE

